

MONITORIMI I FINANCIMIT TË FUSHATAVE ELEKTORALE NË ZGJEDHJET KOMUNALE NË KOSOVË

Të nderuar,

Instituti Demokratik i Kosovës, si degë e Transparency International për Kosovë, në bashkëpunim me Transparency International nga Republika Çeke është duke zhvilluar një hulumtim shpenzimet e subjekteve politike për fushatën elektorale për zgjedhjet e komunale në Kosovë që do të mbahen me 22 tetor 2017.

Për këtë qëllim, kemi përgatitur një pyetësor me tetë pyetje që ju lusim që ta plotësoni për qëllim të këtij hulumtimi. Pyetësorin **ju lusim që ta plotësoni deri më 7 tetor 2017**. Pyetësori llogaritet që merr 15 minuta për t'u plotësuar në tërësi. Përgjigjet tuaja do të na ndihmojnë që të përgatisim një hulumtim me të dhëna të sakta lidhur me shpenzimet e subjekteve politike dhe transparencën e përgjithshme të financimit të subjekteve. Hulumtimi me gjetjet dhe rekomandimet mbi shkallën e transparencës për secilin subjekt do të prezantohet për publik përmes një konference për shtyp bashkë me ekspertët nga Çekia.

Renditja në shkallën e transparencës do të bëhet në bazë të përgjigjeve të subjekteve politike. KDI do të bëjë një verifikim të saktësisë së përgjigjeve, kur është e mundur, dhe do të shikojë edhe faqet e internetit të subjekteve për të mbledhur informacion më të saktë. Hulumtimi do të përmbajë edhe një listë të standardeve më të mira Evropiane dhe praktikave më të mira për raportim të financimit të subjekteve politike gjatë fushatave, me qëllim që këto praktika të adoptohen edhe nga subjektet në Kosovë.

Shpresojmë që të marrim përgjigjen tuaj brenda afatit. Për çdo paqartësi apo pyetje që mund të keni ju lutem na kontaktoni në fspahija@kdi-kosova.org.

Me respekt,
Florent Spahija
Këshilltar Ligjor në Programin Transparenca dhe Kundër Korrupsioni
Instituti Demokratik i Kosovës - KDI



Përgjigjet nga Subjektet politike në pyetjet e dërguara nga KDI

Subjekti politik: FJALA Pyetjet/Përgjigjet

1. A mund ta përshkruani detajisht, buxhetin tuaj për fushatë zgjedhore dhe të përshkruani burimet e financimit të fushatës:

totali: 2000 (dy mijë) EUR
sponsorizimi nga korporatat: %
donacione (individuale): %
kreditë bankare(ose nga institucione tjera): %
burimet publike: %

2. Sa planifikoni të jenë shpenzimet e fushatës së subjektit tuaj?

2000 euro (dy mijë euro) për çertifikim të partisë politike FJALA i kemi paguar për të hy në garën zgjedhore. Dhe flajerat të formatit A4 të cilat do iu shpërndajmë qytetarëve . Këto flajera i ka shtypur një kandidat i yni për asamble komunale. Dhe vizitkartat të cilat po i shtypin në mënyrë individuale disa nga kandidatët për asamble komunale.

3. Në çfarë forma do të zhvillohet fushata juaj (sipas vlerësimit tuaj)?

evente publike: %
bilborde/pankarta/postera: %
reklama në media: %
media on-line: %
media sociale: %
tjera (specifiko): kontakte me qytetarë dhe në rrjetin social FB.%

4. Sa është përqindja e financave të partisë e dedikuar për fushatë (për kandidatët individual), dhe sa është pjesa që ju duhet ta siguroni vetë (nëse vlen kjo)?

Nuk kemi financa dhe nuk mund të ndajmë përqindje.
Jemi parti politike jo parlamentare dhe nuk marrim financa nga buxheti i Kosovës sikur partitë tjera politike parlamentare. Krejt çka kemi mundur të sigurojmë, kanë qenë financat për çertifikim nga anëtarësia e partisë FJALA. Shuma ka qenë 2000 euro (dy mijë euro).

5. A ekziston një orar i veçantë për publikimin e ngjarjeve/aktiviteteve në kuadër të fushatave, dhe ku mund të gjindet ai? (FaceBook, faqen zyrtare të partisë, buletine të shtypura, tjera.)

 Jo nuk kemi orar të veçantë.

6. A do të kontraktoni dikend (një pale të tretë/agjencion/agjenci për marrëdhënje me publikun) për të organizuar fushatën tuaj/ nëse po, kë?



_____Jo.

7. A keni strukturë organizative të ekipit që do të merret me fushatën tuaj (emrat/rolet/pozitat). A jeni i gatshëm ta publikoni këtë informatë?

Po kemi shtabin zgjedhor të cilin e kryeson Avni Çakmaku.

8. A do ta publikoni raportin e përgjithshëm financiar për fushatë, brenda 6 muaj pas zgjedhjeve? Ku dhe kur mund të kemi qasje në të?

Po, në webfaqen e partisë FJALA : www.partiafjala.com



Subjekti politik: Lidhja Demokratike e Kosovës Pyetjet/Përgjigjet

1. A mund ta përshkruani detajisht, buxhetin tuaj për fushatë zgjedhore dhe të përshkruani burimet e financimit të fushatës:

totali: 450-500,000 EUR
sponsorizimi nga korporatat: _%
donacione (individuale): _%
kreditë bankare(ose nga institucione tjera): _%
burimet publike: 100 %

2. Sa planifikoni të jenë shpenzimet e fushatës së subjektit tuaj?

450,000 – 500,000 EUR

3. Në çfarë forma do të zhvillohet fushata juaj (sipas vlerësimit tuaj)?

evente publike: 50 %
bilborde/pankarta/postera: 5%
reklama në media: 30 %
media on-line: 10%
media sociale: 5%
tjera (specifiko): _%

4. Sa është përqindja e financave të partisë e dedikuar për fushatë (për kandidatët individual), dhe sa është pjesa që ju duhet ta siguron vetë (nëse vlen kjo)?

Buxheti nuk ndahet per kandidate

5. A ekziston një orar i veçantë për publikimin e ngjarjeve/aktiviteteve në kuadër të fushatave, dhe ku mund të gjindet ai? (*FaceBook, faqen zyrtare të partisë, buletine të shtypura, tjera.*)

Facebook te LDK

6. A do të kontraktoni dikend (një pale të tretë/agjencion/agjenci për marrëdhënje me publikun) për të organizuar fushatën tuaj/ nëse po, kë?

Kemi kontraktuar kompani te ndara per marredhenje me publikun dhe strategjine e fushates (Entermedia) dhe per organizimin e eventeve zgjedhore (KD Events)

7. A keni strukturë organizative të ekipit që do të merret me fushatën tuaj (emrat/rolet/pozitat). A jeni i gatshëm ta publikoni këtë informatë?

Eshte themeluar Shtabi Qendror per fushate, kurse shumica e antareve te kryesise jane antare sipas fushave perkatese. LDK eshte e gatshme ta publikoje kete informate

8. A do ta publikoni raportin e përgjithshëm financiar për fushatë, brenda 6 muaj pas zgjedhjeve? Ku dhe kur mund të kemi qasje në të?



PO, menjehere pas publikimit mund te keni qasje ne te!



Subjekti Politik: Partia Social Demokrate e Kosovës Pyetjet/Përgjigjet

1. A mund ta përshkruani detajisht, buxhetin tuaj për fushatë zgjedhore dhe të përshkruani burimet e financimit të fushatës:

totali: do të kalkulojmë në fund të fushatës EUR
sponsorizimi nga korporatat: 0 %
donacione (individuale): 0 %
kreditë bankare(ose nga institucione tjera) : 0 %
burimet publike: 0 %

2. Sa planifikoni të jenë shpenzimet e fushatës së subjektit tuaj?

Shpenzime minimale vetanake të kandidatëve.

3. Në çfarë forma do të zhvillohet fushata juaj (sipas vlerësimit tuaj)?

evente publike: _%
bilborde/pankarta/postera: _%
reklama në media: _%
media on-line: _%
media sociale: _%
tjera (specifiko): *takime me qytetar, takime në ndërmarrje private etj.*

4. Sa është përqindja e financave të partisë e dedikuar për fushatë (për kandidatët individual), dhe sa është pjesa që ju duhet ta siguron vetë (nëse vlen kjo)?

Në mungesë të mjeteve, jemi dakorduar me kandidatët, që ata të përballin vetë shpenzimet e tyre.

5. A ekziston një orar i veçantë për publikimin e ngjarjeve/aktiviteteve në kuadër të fushatave, dhe ku mund të gjindet ai? (FaceBook, faqen zyrtare të partisë, buletine të shtypura, tjera.)

Në FaceBook dhe në web faqën: <http://kosovapsd.blogspot.com>

6. A do të kontraktoni dikend (një pale të tretë/agjencion/agjenci për marrëdhënje me publikun) për të organizuar fushatën tuaj/ nëse po, kë?

Nuk angazhojmë.

7. A keni strukturë organizative të ekipit që do të merret me fushatën tuaj (emrat/rolet/pozitat). A jeni i gatshëm ta publikoni këtë informatë?

Shtabi për tri komuna ku garojmë përbëhet nga personat që janë edhe kandidat.

8. A do ta publikoni raportin e përgjithshëm financiar për fushatë, brenda 6 muaj pas zgjedhjeve? Ku dhe kur mund të kemi qasje në të?

Raportin e përgjithshëm e dorëzojmë në KQZ brenda afatit të caktuar me normat e tyre.



Subjekti politik: Pokret za Gora Pitanja/Odgovor

1. Možete li nam opisati na detaljno svoj budžet za izbornu kampanju i vaše izvore finansiranja kampanje:

ukupno: 3.000,00 EUR
korporativna sponzorstva: 0%
donacije (pojedinci): 0%
bankarski (ili druge) krediti: 0%
javni izvori: 0%
drugo (licni doprinosi) 100%

2. Koji su troškovi kampanje vaše partije, uključujući i pripremne aktivnosti pre početka kampanje? U Evrima?

3.000,00 EUR

3. U kom obliku će vaša kampanja vodi (po vašoj proceni)?

javni događaji: 70%
štampani bilbordi / poster: 10%
štampana oglašavanje u medijima: 5%
on-line mediji: 5%
društveni (socijalni) mediji: 10%
ostalo (navesti): 0%

4. Koliko planirate da potrošite na kampanju vašog subjekta?

3,000.00 EUR

Da li je dostupan javnosti kalendar događaja javnih kampanja i gde se može naći?

Facebook, zvanična partijska internet strana, štampan bilten, itd.?

Trenutno nije ali bice dostupan na Facebook stranici partije i nasih simpatizera

6. Da li ćete koristiti neko (treće strane/agenciju/PR firmu) za vođenje izborne kampanje? Ako je odgovor da, koja su to?

NE

7. Da li dostupan javnosti struktura i ekipa izborne kampanje (imena / uloge / pozicije)? Da li ste spremni da objavite te informacije?

Nije dostupna ali smo spremni objaviti te informacije.

8. Da li će te objaviti ukupni finansijski izveštaj o kampanji u roku od 6 meseca nakon izbora? Gde i kada se to može dogoditi?

Da. Centralnoj izornoj komisiji.



Subjekti politik: Lëvizja për Bashkim Pyetjet/Përgjigjet

1. A mund ta përshkruani detajisht, buxhetin tuaj për fushatë zgjedhore dhe të përshkruani burimet e financimit të fushatës:

totali: _____ 5000 _____ EUR
sponsorizimi nga korporatat: 00_%
donacione (individuale): 100_%
kreditë bankare(ose nga institucione tjera): 00_%
burimet publike: 00_%

2. Sa planifikoni të jenë shpenzimet e fushatës së subjektit tuaj?

_____ 3500-4000 euro _____

3. Në çfarë forma do të zhvillohet fushata juaj (sipas vlerësimit tuaj)?

evente publike: 5%
bilborde/pankarta/postera: 00%
reklama në media: 00%
media on-line: 00%
media sociale: 00%
tjera (specifiko): 95% Kartela te kandidatëve, karburante, telefonata dhe ndonje takim me zgjedhes

4. Sa është përqindja e financave të partisë e dedikuar për fushatë (për kandidatët individual), dhe sa është pjesa që ju duhet ta siguron vetë (nëse vlen kjo)?

_____ 50% Partia – 50% kandidatët _____

5. A ekziston një orar i veçantë për publikimin e ngjarjeve/aktiviteteve në kuadër të fushatave, dhe ku mund të gjindet ai? (*FaceBook, faqen zyrtare të partisë, buletine të shtypura, tjera.*)

_____ Jo, nuk ekziston _____

6. A do të kontraktoni dikend (një pale të tretë/agjencion/agjenci për marrëdhënje me publikun) për të organizuar fushatën tuaj/ nëse po, kë?

_____ JO _____

7. A keni strukturë organizative të ekipit që do të merret me fushatën tuaj (emrat/rolet/pozitat). A jeni i gatshëm ta publikoni këtë informatë?

_____ PO, ka shtabin zgjedhor, Avni Klinaku Shef i Shtabit, Agim Kuleta anetare etj _____

8. A do ta publikoni raportin e përgjithshëm financiar për fushatë, brenda 6 muaj pas zgjedhjeve? Ku dhe kur mund të kemi qasje në të?

_____ Po, gjithsesi _____